



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. \_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 01.03.2022

## NJOFTIM PËR APLIKIM VLERËSUES TË INSTITUCIONEVE ARSIMORE PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të Marrëveshjes së bashkëpunimit, nr. 248 Prot., datë 12.11.2021 CSL dhe nr. 930 Prot., datë 12.11.2021 ASCAP, ndërmjet Qendrës “Shkolla e Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar” dhe Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar për “Krijimin e Rrjetit të Vlerësuesve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar”, njoftohen të gjithë personat e interesuar se ASCAP në bashkëpunim me Shkollën e Drejtorëve shpall kërkesën për “**Vlerësues të Institucioneve arsimore**”.

***Kandidati për vlerësues i institucioneve arsimore parauniversitare duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:***

- a) të ketë të paktën 5 vjet përvojë të suksesshme në mësimdhënie dhe 3 vjet përvojë të suksesshme në drejtimin e IAP-së ose 3 vjet përvojë si specialist në institucionet e arsimit parauniversitar;
- b) të zotërojë diplomë universitare të nivelit “Master Shkencor” ose të barasvlershme me të në profilin mësuesi/shkenca edukimi, sipas përcaktimeve të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- c) të ketë fituar të paktën titullin “Mësues i kualifikuar”, vlerësuar “Shumë mirë” ose “Shkëlqyeshëm”;
- d) (mundësisht) të ketë kryer trajnimin përgatitor në Shkollën e Drejtorëve, për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe të jetë certifikuar (vlen për drejtuesit e IAP-ve);
- e) të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze ose të një gjuhe tjetër të BE-së;
- f) të përdorë efektivisht TIK-un;
- g) të ketë marrë pjesë në trajnime për zhvillimin profesional;
- h) të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij.

**Kandidati i interesuar duhet të paraqesë dokumentacionin e aplikimit që përmban:**

- a) jetëshkrimin dhe kopjet e njësuar me origjinalin të dokumenteve;
- b) kopjen e njësuar me origjinalin të librezës së punës;
- c) kopjen e dokumentit të identitetit (ID);
- d) certifikatën e drejtuesit të IAP-së (vetëm për drejtuesit e IAP-ve), të lëshuar nga CSL-ja;
- e) vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
- f) vërtetim nga institucioni ku punon, që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- g) certifikatat e trajnimeve;
- h) letër rekomandimi nga eprori.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhen pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) me adresë:

**Rruga “Naim Frashëri”, Nr.37, Tiranë.**

Afati i dorëzimit të dokumenteve është deri me **datë 20.03.2022, ora 14.00.**

*Ky njoftim vlen për periudhën e dytë, në të cilën ftohen të aplikojnë specialistët e DRAP-it Fier, ZVAP-ve Fier, Vlorë-Himarë, Lushnjë, Divjakë, Mallakastër, Roskovec, Patos, Selenicë, Tepelenë-Memaliaj, Finiq-Dropull, Gjirokastër-Libohovë, Përmet-Këlcyrë, Sarandë-Delvinë-Konispol, si dhe drejtues shkollash në juridiksionin e ZVAP-ve të mësipërme.*

**Faleminderit!**